



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Kontabiliteti Financiar EKB0016

Data e aprovimit:	Data
Verzioni:	Verzion
ECTS:	8
Bartësi i lëndës:	Hazir Gashi
Email:	hazir.gashi@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322

Hyrje:

Lënda KONATABILITETI FINANCIAR ka për synim kryesor ngritjen e njohurive teorike dhe praktike të fituara në lëndën kontabiliteti (bazat) që gjatë evidentimit të ndërrimeve ekonomike në ndërmarrje dhe krijimit të raporteve të mësojnë ti zbatojë ligjet dhe standardet Kombëtare si dhe ato ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe Standardet e Raportimit Financiar.

Qëllimet

Përmes ligjëratave dhe ushtrimeve synohet që njohuritë e fituara në bazat e kontabilitetit, studentët t'i zgjerojnë dituritë e fituara, të aftësohen që nga të dhënat e evidentuara në librin kryesor dhe evidenca tjera ndihmëse të sajojnë pasqyra financiare dhe raporte tjera varësisht nga kërkesat e shfrytëzuesve të informacioneve kontabël. Gjatë sajimit të raporteve financiare studentët do të aftësohet t'i zbatojnë SKK,SNK,SNRF si dhe ligjeve tjera të Republikës së Kosovës që rregullojnë këtë materie. Njohuritë e fituara në lëndën kontabiliteti financiar do të shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimit të lëndëve si kontabiliteti menaxherial, analiza financiare, menaxhmenti financiar auditimi si dhe lëndëve tjera të ngjashme të kësaj fushe."

Rezultatet e pritura të lëndës

- Të kenë mundësi ti kuptojnë raportet nga pasqyrat financiare dhe për të marrë vendime në bazë të informatave të siguruar nga kontabiliteti
- Të interpretojnë informatat e kontabilitetit te palët e interesuara
- Të përpilojnë pasqyrat financiare
- Të aplikojnë teknologjinë informative në evidencat kontabël dhe në nxjerrjen e pasqyrave financiare

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	PREZANTIMI I PROGRAMIT	RIKUJTIM I TEMAVE NGA VITI I PARË – KONTABILITETI BAZË

	(Sylabusit)	
2	LLOGARITË KONTROLLUESE DHE HARMONIZIMET BANKARE	Çfarë janë llogaritë kontrolluese, Zbritjet, Veprimet me llogaritë kontrolluese, Qëllimi i llogarive kontrolluese, Ekstraktet bankare dhe libri i arkës, Harmonizimet bankare
3	KORRIGJIMI I GABIMEVE	Llojet e gabimeve në kontabilitet, Korrigjimi i gabimeve, SNK 8 Gabimet materiale
4	PËRGATITJA E PASQYRAVE FINANCIARE PËR BIZNESE INDIVIDUALE DHE REGJISTRAT JO TË PLOTË	Përgatitja e pasqyrave përfundimtare, Bilanci fillestar i gjendjes, Shitjet – Llogaritë e arkëtueshme, Blerjet – Llogaritë e pagueshme, Kosto e shitjeve, Asgjësimi i stokut, dëmtimet si dhe vjedhjet, Libri i arkës, Akrualet dhe parapagimet, Tërheqjet, Ekuacioni i biznesit
5	PARTNERITETET	Karakteristikat e partneriteteve, Përgatitja e pasqyrave financiare për partneritete
6	DETYRIMET KUPTIMI DHE NDARJA E TYRE	Tatimi mbi të ardhurat e korporatave, Tatimi dhe kontributet nga të ardhurat personale, Pagat e te punësuarve
7	DETYRIMET, KUPTIMI DHE NDARJA E TYRE	TVSH, Dogana dhe akciza
8	DETYRIMET, KUPTIMI DHE NDARJA E TYRE	Detyrimet afatgjata, Detyrime për taksa dhe tatime, Detyrime tjera
9	KONTABILITETI I KORPORATAVE	Përgjegjësia e kufizuar dhe regjistrat e kontabilitetit, Kapitali aksionar, Rezervat, Emetimet bonus dhe për të drejtat, Librat e llogarive dhe kompanitë me përgjegjësi të kufizuar
10	KONTABILITETI I QERASË (LIZINGUT) DHE INVESTIMET NË LETRA ME VLERË	Qiraja operative, Qiraja kapitale, Letrat me vlerë, Fletëobligacionet
11	SHPENZIMET, TË DALAT DHE TË ARDHURAT	Shpenzimet dhe llojet e tyre, Të dalat nga veprimtaria e rregullt, Të dalat nga veprimtaria jo e rregullt, Të ardhurat nga veprimtaria e rregullt, Të ardhurat e jashtëzakonshme
12	PUNËT PËRGADITORE PËR SAJIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË KORPORATAVE	Paraqitja e pasqyrave financiare, Zërat e pasqyrës së të ardhurave, Zërat e bilancit të gjendjes, Dallimi mes qarkulluese / jo qarkulluese si dhe afatshkurtëra dhe afatgjata, Pasqyra financiare e kompanisë për nevoja të brendshme, Të hyrat, Pasqyrat e publikuara financiare, Ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes
13	VEPRIMTARIT E BIZNESIT, BURIMI I KONTABILITETIT	Llojet e veprimtarive dhe analiza e tyre, Veprimtaritë OPERATIVE, Veprimtaritë FINANCIARE, Veprimtaritë INVESTUESE, Komentimi i rasteve të pasqyrave të rrjedhës së parasë sipas veprimtarive
14	PASQYRA E RRJEDHËS SË ARKËS DHE PASQYRA E KAPITALIT TË PRONARIT	Pasqyra e rrjedhjeve të arkës, Përgatitja e pasqyrës së rrjedhjes së arkës, Metoda e drejtpërdrejtë (direkte), Metoda e tërthortë (indirekte), Përgatitja e pasqyrës së kapitalit të pronarëve
15	SISTEMI INFORMATIK I KONTABILITETIT	PËRMBLEDHJE E TË GJITHA LIGJËRATAVE

Informata shtesë 1:

Gjate ligjëratave do të ketë më tepër pjesë teorike por do të kombinohet edhe me zgjidhje të shembujve konkret në raportin 70% teori dhe 30% praktikë. Kurse gjatë ushtrimeve kryesisht do të ketë zgjidhje praktike të detyrave konkrete si dhe teori vetëm sa për të sqaruar shembujt konkret në raportin 20% teori dhe 80% praktikë. Studentët të cilët nuk janë të rregullt në ligjërata nuk mund të arrijnë 10% të pikëve që nënkupton se zbresin për një notë, pra maksimalisht mund të arrijnë notën 9. Kurse studentët të cilët nuk dorëzojnë asnjë nga detyrat e shtëpisë nuk e realizojnë lartësinë e pikëve 20 që është e barasvlershme me dy nota.

Informata shtesë 2:

Si mjet konkretizimi do të përdoren kompjuterët me projektor për mes prezantimeve të ligjëratave dhe shembujve, do të përdoret edhe tabela e bardhe me marker si dhe në disa raste tabela interaktive. Gjithashtu studentëve do të ju shpërndahen fleta me shembuj dhe detyra të shtypura e të cilat do ti punojnë individualisht dhe në grupe. Disa detyra do ti zbatojnë me softuerë përkatës përmes kompjuterëve.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji Vleresimit	Perqindja	Pershkrimi
1	Test	35	Në këtë test shtrohen detyra nga pjesa e parë e shpjeguar. Do të ketë pyetje me shumë zgjedhje, pyetje tekstuale si dhe detyra me ndërrime ekonomike dhe përgatitje të pasqyrave.
2	Test	35	Në këtë test shtrohen detyra nga pjesa e dytë e shpjeguar. Do të ketë pyetje me shumë zgjedhje, pyetje tekstuale si dhe detyra me ndërrime ekonomike dhe përgatitje të pasqyrave.
3	Pjesëmarrja	10	10% Vlerësohet vijueshmëria e studentit por edhe sa ka qenë aktiv në orët mësimore. Si dhe 10% vlerësohet dorëzimi i punimit
4	Detyra	20	Gjate semestrit studenti do te kete detyra.

Kushtet e përsëritjes:

Studenti obligohet të japë me sukses lëndën brenda 3 afateve të nënshtruara të provimit. Nëse studentit nuk i nënshtrohet provimit të lëndës së caktuar në afatin e dhënë, atëherë atij i llogaritet se ka shpenzuar afatin brenda viti akademik. Nëse pas 3 nënshtrimeve të provimit, studentit nuk jep lëndën atëherë ai obligohet të dëgjoj sërish lëndën në vitin vijues akademik.

Burimet:

- 1. "P1- Kontabiliteti Financiar" - ShKÇAK, 2. "Kontabiliteti Financiar" Information for Decisions, Prishtinë 2004, 3. "Kontabiliteti Financiar" –Sotiraq Dhamo, Tiranë 2003, 4. "Kontabiliteti Financiar (Pjesa e dytë)" – Skender Ahmeti, Prishtinë, 5. "Kontabiliteti Financiar" – Rustem Asllani, Prishtinë 2010,

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	30	
Ushtrime:	30	
L+U:	60	
Seminar/praktike.:	30	
Studim i vazhdushem:	90	
Pregaditja e Provimit:	20	
Pjesemarrja ne teste:	4	

Pjesemarija ne provimin final:	2	
Me profesorin dhe asistentin:	4	
Total Ore:	210	
ECTS:	8	